



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.08.2022, ora 15.00

Drejton mbledhjen Sokol Binaj – Kryetar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

Rendi i Ditës:

- 1. Miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 21.02.2019, rishpallur me datë 19.04.2019, rishpallur me datë 03.06.2021 si dhe rishpallur me datë 15.11.2021.*

Marrin pjesë:

- | | |
|--------------------------|----------------------|
| 1. Sokol Binaj | (kryetar) |
| 2. Marsida Xhaferllari | (zëvendës kryetare) |
| 3. Anila Leka | (anëtare) |
| 4. Elsa Toska | (anëtare) |
| 5. Klodiana Mema (Veizi) | (anëtare) |
| 6. Etien Kapo | (anëtar) |
| 7. Genti Xholi | (anëtar zëvendësues) |

HAPET MBLEDHJA: ora 15:05

Sokol Binaj – Atëhere vazhdojmë mbledhjen e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për të konkluduar me miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 21.02.2019, rishpallur me datë 19.04.2019, rishpallur me datë 03.06.2021, rishpallur me datë 15.11.2021.

Verifikojmë prezencën e anëtarësisë, të pranishëm zonja Xhaferllari, zonja Leka, zonja Toska, zonja Mema, zoti Xholi, zoti Kapo dhe Binaj. Nuk janë paraqitur Dhimitri dhe Petri, kanë njoftuar për pamundësi të natyrës objektive për tu paraqitur në mbledhjen e sotme. Atëhere vazhdojmë, kuorumin e kemi, mund të vazhdojmë. Është i pranishëm përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, zoti Haxhimihali. Me raportin janë njohur anëtarët. Jemi gati atëhere për të vendosur lidhur me miratimin e tij. Me radhë, duke filluar nga zonja Xhaferllari.

Marsida Xhaferllari – Dakord, jam dakord!

Sokol Binaj – Zonja Toska?

Elsa Toska – Dakord!

Sokol Binaj – Faleminderit! Zonja Leka?

Anila Leka – Jam dakord!

Sokol Binaj - Zoti Kapo?

Etien Kapo – Dakord edhe unë.

Sokol Binaj – Zonja Mema?

Klodiana Mema (Veizi) – Dakord!

Sokol Binaj – Zoti Xholi?

Genti Xholi – Dakord!

Sokol Binaj – Dakord edhe unë Binaj. Zoti Haxhimihali?

Enio Haxhimihali – Nëse dëshironi, mund të shtoni një paragraf në raport që gjatë gjithë procedurës ka qënë prezent dhe institucioni i Avokatit të Popullit, gjë që në një lexim të shpejtë sikur më humbi, nuk ma kapi syri. Nëse e vlerësoni të arsyeshme, rekomandojmë të shtohet dhe ky paragraf. Faleminderit!

Sokol Binaj – Një fjali tek... Dakord jeni atëhere që ta shtojmë?

Anëtarët janë dakord

Sokol Binaj – Atëhere ramë dakort në unanimitet për të shtuar në raport edhe pasqyrimin e prezencës së përfaqësuesit të Avokatit të Popullit përgjatë gjithë procedurës së vlerësimit/renditjes së kandidatëve për këtë vakancë.

Enio Haxhimihali – Avokatit edhe, se në një pjesë të mbledhjeve ka qënë edhe Avokatja, jo gjithmonë ka qënë unë.

Sokol Binaj – E qartë, atëhere Avokatit edhe të përfaqësuesit.

Enio Haxhimihali – Institucionit.

Sokol Binaj – Institucionit të Avokatit të Popullit të përfaqësuar në këtë mbledhje.

Atëhere vendim, u vendos përfundimisht, ramë dakord “Për miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 21.02.2019, rishpallur me datë 19.04.2019, rishpallur me datat 03.06.2021, 15.11.2021”.

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 147 dhe të pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të shkronjës “e” të pikës 2 të nenit 201 dhe të pikës 5 të nenit 229 të 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, si dhe të pikave 71 dhe 72 të vendimit nr. 5, datë 02.04.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, pasi e bisedoi çështjen, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Miratimin e raportit për renditjen e kandidatëve të lejuar për plotësimin e vendit vakant të gjyqtarit të Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Gjykata e Lartë në datë 21.02.2019, rishpallur me datë 19.04.2019, rishpallur me datë 03.06.2021 dhe rishpallur me datë 15.11.2021.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

Atëhere mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Marsida Xhaferllari – Përpara se ta, vetëm për njoftimin.

Sokol Binaj – Po, fjalën e ka zonja Xhaferllari.

Marsida Xhaferllari - Për njoftimin e kandidatës Juliana Latifi të cilën sekretaria ia ka komunikuar nëpërmjet numrit të saj të celularit me whats app vendimet e plota të arsyetuara të KED-së, dhe ndoshta do ishte mirë që sekretaria të pasqyroste në një proces-verbal që janë çuar sot me whats app dhe janë marrë, janë lexuar prej saj, sepse kuptohet nga sinjali që bën blu, jeshil, ç`farë bën, që bën whats app-i.

Elsa Toska – Sinjali që është parë.

Marsida Xhaferllari - Që është parë, që është lexuar. Thjesht për të qënë në rregull me...

Sokol Binaj – Unë dakord jam! Për të dokumentuar veprimin e kryer nga sekretaria, pa asnjë lloj problemi, edhe ti bashkëlidhet praktikës.

Marsida Xhaferllari - Dhe në mbledhjen e radhës të verifikojmë nëse ka bërë ankim apo jo!

Sokol Binaj – Atëhere ka detyrimin sekretaria pas kryerjes së dërgimit të vendimt nëpërmjet rrugës elektronike whats app, të pasqyrojë veprimin nëpërmjet një proces-verbali dhe akti i dokumentimit të depozitohet në dosjen e kandidatit. Dakord jemi?

Anëtarët janë dakord

Sokol Binaj – Dakord atëhere!

Flasin pa mikrofon.

Sokol Binaj – Faleminderit! Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Mbledhjen e konsiderojmë të mbyllur.

Tiranë me datë 12.08.2022

KRYETAR

Sokol BINAJ

